



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government
Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë/Ministarstvo Industrije, Preduzetništva i
Tergovine/Ministry of Industry, Entrepreneurship and Trade

Njësia e Burimeve Njerëzore/ Jedinica Ljudski Resursa/ Human Resources Unit

Ref.03/Pers.nr.06

Datë:18.06.2024

Njësia e Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, në mbështetje të nenit 39 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë (G.Z./Nr.21/18 Shtator 2023) dhe Rregullores (QRK) NR. 15/2023 Për procedurën e pranimit në shërbimin civil, nxjerr:

V E N D I M

1. Anulohet konkursi “Drejtor i Departamentit të Tregtisë” me Nr. RN. 00010807, Kodi RPC 0004027, i publikuar me date 26.01.2023 për ngritje (avancim) në detyrë.

ARSYETIM

Njësia e Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë gjatë verifikimit paraprak ka konstatuar se në konkursin e publikuar me datë 26.01.2023, për ngritje (avancim) në detyrën për pozitën “Drejtor i Departamentit të Tregtisë”, ka konstatuar se ka gabime teknike në verifikimin paraprak të kandidatëve përzgjedhës, si dhe pozita e koordinatorit është marrë si pozitë Udhëheqëse pasi që me Ligjin Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, kjo pozitë nuk konsiderohet pozitë Udhëheqëse, gjë që ka vlerësuar se është e nevojshme të bëhet anulimi i këtij konkursi në këtë fazë.

Andaj Njësia e Burimeve Njerëzore konform Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë (G.Z./Nr.21/18 Shtator 2023) dhe Rregullores (QRK) NR. 15/2023 Për procedurën e pranimit në shërbimin civil, merr vendim sipas dispozitës së lartëcekur.

2. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet vendimi Nr.3144/03 date 18.06.2024.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij Vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë në ankesë në afat prej pesëmbëdhjete (15) ditësh. Ankesa i dërgohet Njesisë së Burimeve Njerëzore në kuadër të MINT.

U.d Udhëheqëse e Njesisë së Burimeve Njerëzore

